

PROCESVERBAL
nga seanca e 11-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 23.3.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, mr. Emilija Janevska, Goran Radunović, mr. Ivona Mufisheva, mr. Magdalena Davidovska-Dovleva, dr. Ivana Stojanovska, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 11-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 10:05 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 10-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 10.3.2026.
2. Draft-raporti vjetor mbi punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025.
3. Propozim-vendim për heqjen e lejes për transmetimit televiziv të ShTR TV Gurra ShPKNJ P Kërçovë.
4. Propozim për shqiptim e masës paralajmërim publik ndaj ShPTSh Inovator JSMS Tesla ShPKNJ P Sveti Nikole, botues i medias së shkruar "BALKANIUM", për shkelje të nenit 14, paragrafi (1) të Ligjit për Media.
5. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: licencë për softuer për ruajtje automatike të të dhënave dhe mbrojtje antivirus.

6. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: mirëmbajtje dhe servisim i sistemit për ftohje, ngrohje dhe ventilim.
7. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: mirëmbajtje adaptive dhe parandaluese e softuerit ekzistues për analizën e programeve në RA dhe TV - NAVS.
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së 10-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 10.3.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi Draft-raportin vjetor të punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025. Ai shpjegoi se Agjencia ka detyrim ligjor Raportin e Punës së Agjencisë për vitin e kaluar ta dorëzojë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut jo më vonë se 31 mars të vitit aktual. Ai deklaroi se dokumenti është dorëzuar në Këshill si draft-version, me qëllim që të shqyrtohet në seancën e radhës, pas së cilës versioni përfundimtar do të dorëzohet për miratim në seancën e caktuar të hënën e ardhshme. Edhe pse Agjencia nuk ka detyrim ligjor që Raportin fillimisht ta dorëzojë në Këshill si draft-version, drejtori theksoi se, me qëllim që të shmangen lëshimet e mundshme, gabimet teknike, vërejtje ose përgatitjen e aktiviteteve të realizuara gjatë vitit të kaluar, dokumenti po shqyrtohet në dy faza. Në këtë drejtim, ai u bëri thirrje anëtarëve të Këshillit, nëse kanë ndonjë vërejtje ose propozim, t'i dorëzojnë me shkrim në ditët në vijim, në mënyrë që në kohë të mund të përfshihen në versionin përfundimtar. Ai gjithashtu theksoi se teksti i këtij Draft-raporti ende nuk është lektoruar për shkak të vëllimit, por versioni përfundimtar që do t'i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut do të lektorohet në mënyrë të përshtatshme gjuhësore. Ai shpjegoi se draft-versioni përfshin të gjitha aktivitetet e realizuara nga Agjencia gjatë vitit 2025, dhe si shtojcë përmban dhe Raportin për realizimin e Planit vjetor të mbikëqyrjes programore, si dhe Raportin financiar për realizimin e planit financiar. Në drejtim të avancimit të rregullativës mediatike, informoi se Agjencia ka paraqitur dy iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në Ministrinë e transformimit digjital - njëra për fillimin e aktiviteteve për krijimin e Fondit për pluralizmin mediatik dhe tjetra për futjen e radios digjitale. Përveç kësaj, Agjencia mori pjesë aktive në procesin e ndryshimit të Ligjit për Mediat, i cili përfshin portalet e internetit në kuadër të rregullimit të medias.

Si një nga aktivitetet më të rëndësishme, ai theksoi realizimin e monitorimit të zgjedhjeve lokale, gjatë të cilave u konstatua se transmetuesit kryesisht respektuan rregullat për raportim të balancuar, reklamim politik dhe përfaqësim politik pa pagesë. Përjashtim bënë rastet individuale të mosrespektimit të heshtjes zgjedhore në rrethin e parë, për të cilat u iniciuan procedura kundërvajtëse, ndërsa në rrethin e dytë nuk u konstatuan parregullsi. Në

lidhje me reklamimin e paguar politik, informoi se vetëm një transmetues tejkaloi limitin ligjor, dhe kjo ishte në rrethin e parë të zgjedhjeve, për të cilin Agjencia inicioi procedurë kundërvajtëse. Gjatë vitit 2025, për herë të parë në Maqedoni u krijua një regjistër i mediave online - portaleve të internetit, në të cilin aktualisht janë të regjistruar 60 portale. Janë realizuar mbi 400 mbikëqyrje mbi subjekte që janë lëndë të rregullativës, duke përfshirë mbi 300 transmetues, 99 operatorë të rrjeteve publike të komunikimit elektronik, 10 mbi botuesit e mediave të shtypit dhe 7 ofrues të shërbimeve me kërkesë. Për shkeljet e konstatuara gjatë këtyre mbikëqyrjeve u shqiptuan gjithsej 50 masa nga të cilat 40 ishin paralajmërime publike. U ndanë katër leje për transmetim në radio në nivel lokal, dhe pesë transmetuesve i skadoi vlefshmëria e lejes. Ai theksoi se këtë vit, Agjencia koordinoi edhe organizimin e Ditëve të Arsimimit Mediatik, të cilat u mbajtën në nëntor 2025. Nën moton "Ti e di tjetri nuk e di. Komenti yt mund të ndihmojë!", në kuadër të Ditëve të Arsimimit Mediatik u realizuan më shumë se 20 evente në lokacione të ndryshme në vend dhe online. Janë përgatitur disa analiza dhe studime: tre studime për të përcaktuar nëse ka arsytim për shpallje të konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim dhe katër analiza: Analiza e tregut të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele për vitin 2025, Analiza e strukturës së punonjësve në industri, Analiza e arsytimit dhe mundësive për futjen e masave mbështetëse për transmetuesit rajonal dhe lokal dhe Analiza e tregut të përgjithshëm mediatik, si dhe u konceptua edhe Hulumtimi i mendimit dhe qëndrimit publik në lidhje me mediat. Në nivel ndërkombëtar, Agjencia mori pjesë në punën e disa rrjeteve rregullatore evropiane dhe rajonale, si dhe në takime dypalëshe me rregullatorë dhe ambasada të huaja. Siç u përmend, në shtojcë ndaj Raportiot është dhe Raporti mbi zbatimin e planit vjetor për mbikëqyrje programore, nga ku shihet se janë realizuar të gjitha mbikëqyrjet e planifikuara dhe Raporti për realizimin e planit financiar të Agjencisë. Në lidhje me llogarinë përfundimtare, ai përkujtoi se vitin e kaluar të ardhurat e Agjencisë ishin 5,6 milionë denarë më të ulëta në lidhje me shpenzimet që do të thotë se Agjencia arriti rezultat negativ.

Këshilltarja mr. Gordana Majnova, theksoi se Raporti është gjithëpërfshirës, i detajuar dhe i strukturuar mirë dhe se në këtë moment nuk ka vërejtje konkrete. Ajo theksoi se me kujdes e ndjek ekspozen e drejtorit dhe shtoi se është e mundur që vërejtje të caktuara të dalin shtesë për shërbimin profesional, përkatësisht pas një rishqyrtimi të tekstit. Megjithatë, ajo theksoi se për momentin nuk ka vërejtje dhe vlerësoi se raporti është përgatitur shkëlqyeshëm dhe beson se, në këtë mënyrë, duhet të propozohet për miratim dhe dorëzim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga vlerësoi se Raporti është i plotë dhe i shpjeguar detajisht. Ajo theksoi se Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ka paraqitur dy nisma të rëndësishme. E para lidhet me avancimin e radios digjitale, e cila do të kontribuojë në modernizimin e eterit mediatik dhe sigurimin e një sinjali me cilësi më të lartë për dëgjuesit. Përveç kësaj, ajo iu referua nismës për formimin e Fondit për mbështetjen e pluralizmit mediatik, duke vlerësuar se me këtë Agjencia jo vetëm që kryen mbikëqyrje, por në mënyrë aktive propozon zgjidhje sistematike për zhvillimin e sektorit mediatik. Ajo gjithashtu theksoi se, siç u përmend nga drejtori, të dy nismat janë paraqitur pranë ministrisë kompetente, që tregon një rol proaktiv të organit rregullator në procesin e përgatitjes së ndryshimeve ligjore. Së fundmi, ajo kërkoi informacione shtesë mbi rrjedhën e procedurës në lidhje me nismat e lartpërmendura dhe mundësinë e realizimit të tyre gjatë vitit 2026.

Kryetari i Këshillit, mr. Stefanovski, vlerësoi se Draft-raporti është gjithëpërfshirës dhe i saktë, duke vënë në dukje se nëse ka gabime të caktuara, ato janë të një shkalle më të vogël

dhe kryesisht të natyrës teknike, duke shprehur besimin se në versionin përfundimtar do të korrigjohen dhe teksti do të lektorohet në mënyrë të përshtatshme. Ai shtoi se ka edhe një javë në dispozicion për përmirësimin e mëtejshëm të tekstit, si dhe për paraqitje të propozimeve dhe vërejtje nga anëtarët e Këshillit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Draft-raportin vjetor të punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Drejtori Trajçevski shpjegoi Vendimin e propozuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV Gurra ShPKNJ P Kërçovë. Ai shpjegoi se Agjencia këtij transmetuesi i ka dhënë (lëshuar) faturë për kompensimin vjetor më 12 janar 2026. Ka pasur probleme me dorëzimin e faturës, sepse transmetuesi nuk e ka marrë dërgesën, për të cilën Agjencia është njoftuar nga shërbimi postar. Fatura më pas është dorëzuar në adresën zyrtare në e-mail të transmetuesit, të regjistruar në Regjistrin Qendror, por edhe pas skadimit të afatit prej 30 ditësh nga dorëzimi, transmetuesi nuk ka kryer pagesën e kompensimit për transmetim televiziv. Pas skadimit të afatit ligjor, para dy javësh, Këshilli ka inicuar procedurë për heqjen e lejes të TV Gurra, por edhe në afatin plotësues prej 15 ditësh transmetuesi nuk e ka kryer pagesën. Bëhet fjalë për shumë prej 118.740,00 denarë. Drejtori informoi se javën e kaluar Agjencia ka marrë një shkresë nga TV Gurra me të cilën kërkohet që t'u jepet afat shtesë prej 15 ditësh, përkatësisht deri më 31 mars, për të kryer pagesën. Megjithatë, në përputhje me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe aktet nënligjore, Agjencia nuk është në gjendje të miratoi afat plotësues, pasi janë shterur të gjitha afatet ligjore. Nga dita e dhënies së faturës, 12 janar deri në ditën e vendimit, 23 mars kanë kaluar më shumë se dy muaj dhe transmetuesi ka detyrim ligjor të paguajë kompensimin (tarifën) në afat prej 30 ditësh nga pranimi i faturës. Pas heqjes së lejes, transmetuesi ka mundësinë, nëse paguan shumën e plotë të kompensimit, të iniciojë procedurë para Gjykatës Administrative për anulimin e Vendimit për heqjen e lejes të miratuar nga Këshilli i Agjencisë. Në atë rast, transmetuesi do të duhet të përballojë edhe shpenzimet shtesë që do të shkarkohen nga Agjencia, përkatësisht: shpenzimet për publikimin e vendimit për heqjen e lejes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", si dhe shpenzimet për publikimin e vendimit në dy gazeta ditore në gjuhën shqipe dhe maqedonisht, si dhe shpenzimet për ribotim në "Gazetën Zyrtare" në rast të anulimit të vendimit. Kështu, zhvillimi i mundshëm i procedurave para Gjykatës Administrative do të nënkuptonte një rritje shtesë të shpenzimeve për transmetuesin, në shumën prej afërsisht 1.000 euro.

Në pyetjen e këshilltares Jajaga, drejtori dhe kryetari konfirmuan se sot është afati i fundit për pagesën. Plotësuese u dha sqarim se transmetuesi ka llogari të bllokuar, gjë që e ndërlikon më tej situatën.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-58 datë 7.9.2023 të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV Gurra ShPKNJ P Kërçovë, për shkak të mospagesës së kompensimit vjetor të lejes për transmetim televiziv brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës nr.2026-100-0020 datë 12.1.2026 me (nr.ark.05-106/1 datë 12.1.2026).

Fatura nr.2026-100-0020 e datës 12.1.2026 me (nr.ark.05-106/1 e datës 12.1.2026) anulohet dhe ShTR TV Gurra ShPKNJ P Kërçovë i jipet faturë e re, e cila i referohet vetëm

periudhës së punës, përkatësisht deri në ditën e miratimit të këtij Vendimi për heqjen e lejes, e cila duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së faturës.

Spektori për përkrashjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Pika 4

Udhëheqësja e Spektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, shpjegoi propozimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj ShPTSh Inovator JSMS Tesla SJKPNJP Sveti Nikole, botues i medias së shtypit "BALKANIUM", për shkak të shkeljes së nenit 14, paragrafi (1) të Ligjit për Media. Ajo shpjegoi se gjatë muajit shkurt janë kryer mbikëqyrje në gjithsej 16 media të shtypit, në lidhje me detyrimin për publikim impresium në përputhje me dispozitat ligjore. Vetëm në këtë medium të shtypit janë konstatuar shkelje, përkatësisht është konstatuar se në botimin e shtypit "BALKANIUM" impresium nuk i përmban të gjitha të dhënat e parashikuara me Ligj. Në lidhje me shkeljen e konstatuara, nga media është kërkuar të deklarohet, dhe kanë paraqitur deklaratë me shkrim në të cilën thuhet se pranohen konstatimet e Agjencisë dhe se në numrin e ardhshëm kanë korrigjuar lëshimin, përkatësisht impresium është publikuar me të gjitha të dhënat e nevojshme. Megjithatë, duke pasur parasysh se shkelja tashmë është konstatuar, Këshillit i është paraqitur propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik.

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative me nr.03-772/1 të datës 27.2.2026 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë për prodhimtari, tregti dhe shërbime INOVATOR JSMS TESLA SHPKNJJP Sveti Nikole, botues i "BALKANIUM", t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 14, paragrafi (1) të Ligjit për Media, sepse në botimin me nr. 42 të "BALKANIUM" nuk ka publikuar të dhënat mbi: adresën e selisë së botuesit të medias, adresën e redaksisë së botuesit të medias, emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias, adresën e shtypshkronjës dhe datën e shtypjes ose ribotimit.

Në përputhje me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimit të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar nr.01-4241/1 datë 1.10.2025), urdhërohet që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit për ndërmarrjen e masës paralajmërim publik, të harmonizojë punën e saj me nenin 14, paragrafi (1) të Ligjit për Mediat.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj subjektit të mbikëqyrur në fjalë.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit do të ushtrojë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar paralajmërim publik (tërësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar), pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin individual (aktvendim) të miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

Spektori për përkrashjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 5

Ndihmës-udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, mr. Ivona Mufisheva, shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: licenca për softuer për ruajtje automatike të të dhënave dhe mbrojtje nga antiviruset. Ajo shpjegoi se kontrata që do të rezultojë nga procedura do të nënshkruhet (lidhet) për periudhë prej një viti, dhe vlera e parashikuar e furnizimit publik është 600.000,00 denarë. Ajo deklaroi se furnizimi është parashikuar në Planin për furnizime publike për vitin 2026, dhe mjetet janë planifikuar në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2026. Procedura do të zbatohet si furnizim me vlerë të ulët. Realizimin i këtij furnizimi do të sigurojë ruajtje të sigurt dhe të rregullt të të dhënave kritike, si dhe mbrojtje nga kërcënimet që mund të rrezikojnë funksionimin e sistemeve të IT-së. Implementimi i kësaj zgjidhjeje do të minimizojë rrezikun e humbjes së të dhënave dhe nga sulme të mundshme kibernetike, duke siguruar vazhdimësinë e punës dhe sigurinë e informacionit. Ajo theksoi se të gjitha të dhënat e tjera janë të përfshira në materialet e paraqitura për seancë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: licenca për softuer për ruajtjen automatike të të dhënave dhe antivirus.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik - mallra: licenca për softuer për ruajtjen automatike të të dhënave dhe antivirus është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, (Tekst i pastruar) nr.05-869/1 datë 4.3.2026, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.

Pika 6

Drejtori i Agjencisë, dr.Trajçevski, në lidhje me procedurën për furnizim publik - shërbim për mirëmbajtje dhe servisim të sistemit për ftohje, ngrohje dhe ventilim, kërkoi nga udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë, Goran Radunović, të japë sqarim mbi aktivitetet e ndërmarra më parë, duke marrë parasysh se kjo është hera e tretë që shpallet njoftim publik.

Udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë, Goran Radunović, informoi se procedura për furnizimin publik në fjalë filloi në vitin 2025, në afatin e rregullt për fillimin e saj, gjatë të cilit u shpallën dy njoftime publike që përfunduan pa sukses. Ai shpjegoi se për njoftimin e parë aplikoi një operator ekonomik që nuk i plotësonte kushtet e përcaktuara, ndërsa për njoftimin e dytë nuk aplikoi asnjë operator. Ai gjithashtu vuri në dukje se këtë vit, dy seanca më parë, furnizimi publik përsëri u përfshi në Planin për furnizime publike të Agjencisë për vitin 2026, me qëllim që të ri-zbatohet procedura dhe të sigurohet një operator ekonomik i përshtatshëm. Ai theksoi se furnizimi në fjalë është me rëndësi të veçantë, duke pasur parasysh se pajisjet e regjistrimit funksionojnë vazhdimisht, përkatësisht 24 orë në ditë, prandaj është e nevojshme që sistemi për ftohje të mbajë një temperaturë të qëndrueshme. Ai gjithashtu informoi se janë bërë përpjekje edhe përmes kontakteve të drejtpërdrejta me disa kompani që ofrojnë këtë lloj shërbimi, gjatë të cilave ata u ftuan të kryejnë këqyrje në ambientet e Agjencisë. Ai theksoi se vetëm një kompani shprehu interes, e cila pas këqyrjes së kryer deklaroi se nuk ishte e interesuar dhe nuk paraqiti ofertë.

Ndihmës-udhëheqësja, mr. Ivona Mufisheva, shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim për mirëmbajtje dhe servisim

të sistemit për ftohje, ngrohje dhe ventilim. Ajo shpjegoi se kontrata do të lidhet (nënshkruhet) për periudhë prej dy vitesh, me vlerë të parashikuar në total prej 1.520.000,00 denarë, nga të cilat 760.000,00 denarë janë planifikuar në Planin financiar për vitin 2026, ndërsa 760.000,00 denarë të mbetura do të parashikohen në Planin financiar për vitin 2027. Ajo deklaroi se procedura do të zbatohet si procedurë e hapur e thjeshtuar dhe do të realizohet si furnizim në grup me Ministrinë e Sportit, duke marrë parasysh që të dy institucionet ndodhen në të njëjtin ambient pune.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli, duke marrë parasysh rrethanat e paraqitura në lidhje me interesin e kufizuar nga operatorët ekonomikë, pyeti nëse ishte e nevojshme të kryheshin konsultime shtesë me Ministrinë e Sportit, e cila, sipas vlerësimit të saj, mbase ka kryer një furnizim të ngjashëm.

Drejtori Trajçevski shpjegoi se furnizimi po kryhet së bashku me Ministrinë e Sportit, ku Agjencia udhëheq procedurën, dhe detyrimet financiare shpërndahen në mënyrë proporcionale midis dy institucioneve. Në vazhdim, në lidhje me Pikën 3 të rendit të ditës, drejtori informoi se është marrë e-mail nga TV Gurra Kërçovë, në të cilin transmetuesi informoi se kishte kryer pagesën e kompensimit vjetor. Ai sqaroi se pagesa nuk është kryer nga llogaria e personit juridik, por nga person fizik, prandaj dhe kërkoi nga udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë të verifikoj kontrollin e pagesës. Ai theksoi se nëse konstatohet se mjetet janë paguar nga person fizik, ato nuk mund të konsiderohen të ligjshme dhe do të kthehen, në përputhje me Ligjin për Disiplinë Financiare. Megjithatë, nëse konstatohet se pagesa është kryer në përputhje me dispozitat ligjore, Këshilli do të tërheqë Vendimin për marrjen e lejes.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: mirëmbajtje dhe servisim të sistemit për ftohje, ngrohje dhe ventilim.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik-shërbim: mirëmbajtje dhe servisim të sistemit për ftohje, ngrohje dhe ventilim është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, (Tekst i pastruar) nr.05-869/1 datë 4.3.2026, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026, përkatësisht do të parashikohen shtesë në Planin Financiar për vitin 2027.

Pika 7

Ndihmës-udhëheqësja mr. Ivona Mufisheva, shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim për mirëmbajtje adaptive dhe parandaluese të softuerit ekzistues për analizën e programeve transmetuese televizive dhe radio (NAVS). Ajo deklaroi se kontrata që do të rezultojë nga procedura do të jetë e vlefshme për një vit, nga ku shuma totale e mjeteve të nevojshme për realizim është 400.000,00 denarë. Procedura do të zbatohet si furnizim me vlerë të ulët, në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizime publike. Realizimi i këtij furnizimi do të sigurojë funksionim dhe zhvillim të vazhdueshëm dhe me cilësi të lartë të softuerit për analizën e programeve televizive dhe radio. Përveç kësaj, furnizimi do të mundësojë funksionim pandërprerje të sistemit që shfrytëzohet gjatë monitorimit të transmetuesve, duke siguruar mirëmbajtje adaptive dhe parandaluese të softuerit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: mirëmbajtje adaptive dhe parandaluese të softuerit ekzistues për analizën e programeve në RA dhe TV - NAVS .

Zbatimi i procedurës për furnizim publik-shërbim: mirëmbajtje adaptive dhe parandaluese e softuerit ekzistues për analizën e programeve në RA dhe TV - NAVS është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, (Tekst i pastruar) nr.05-869/1 datë datës 4.3.2026, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026, përkatësisht do të parashihen shtesë në Planin Financiar për vitin 2027.

Pika 8

Të ndryshme

Këshilltarja Zirjeta Jajaga, lidhur me procedurën për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV Gurra ShPKNJ P Kërçovë, pyeti nëse ekziston mundësi ligjore që heqja e lejes të shtyhet deri në momentin kur llogaria e transmetuesit të zhblllokohet, në mënyrë që t'i mundësohet përbushja e detyrimit të pagesës.

Drejtori Trajçevski sqaroi se në rastin konkret veprimi kushtëzohet nga dispozitat ligjore në fuqi, duke treguar se pagesa nuk është kryer nga llogaria e transmetuesit, por nga llogaria e një personi tjetër, gjë që nuk është në përputhje me Ligjin për Disiplinën Financiare. Njëkohësisht, rikujtoi se ky ligj është në fuqi prej tre deri në katër vite dhe se subjektet janë të detyruar të veprojnë në përputhje me detyrimet e përcaktuara.

Këshilltarja Gordana Majnova informoi se anëtarët e Këshillit kishin marrë një e-mail nga person anonim në lidhje me përmbajtje të publikuar në rrjetin social Facebook, në faqen e TV Kanal 5. Ajo theksoi se është në dijeni se Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nuk ka kompetenca mbi përmbajtjet e publikuara në rrjetet sociale, por mbi programin e transmetuar, por pyeti nëse, në lidhje me pretendimet për fyerje, shpifje dhe gjuhës së urrejtjes, Agjencia, përkatësisht shërbimi profesional, komunikon me mediat me qëllim që të nxjerrë në pah dhe parandalojë fenomene të tilla. Përveç kësaj, ajo e theksoi përmbajtjen si të papërshtatshme dhe kërkoi informacion nëse Agjencia kishte ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me rastin konkret.

Drejtori Trajçevski shpjegoi se Agjencia vepron pas çdo ankese të paraqitur, me ç'rast dërgohet përgjigje drejtuar parashtruesit dhe transmetuesit, në përputhje me praktikën e vendosur. Gjithashtu deklaroi se, në rastet kur Agjencia nuk është kompetente për të vepruar, parashtruesit informohen për arsyet dhe udhëzohen në institucionet kompetente.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani